



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë, më 06.02.2020

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR

I. HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 06.02.2020 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, propozim i një grupi deputetësh. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Klotilda Bushka (Ferhati).

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm, znj. Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie; z. Maksim Qoku, nënkryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe z. Ilir Toska, anëtar i këtij Këshilli; z. Kujtim Luli, përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme; znj. Danja Hobdari, përfaqësuese e Këshillit të Lartë të Prokurorisë; z. Greg Borkowski, ekspert ndërkombëtar i Misionit EURALIUS V dhe z. Tedi Dobi, ekspert vendas pranë këtij misioni.

II. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim i një grupi deputetësh, sipas përcaktimeve të neneve 81, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në shkronjën “e” të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës sipas të cilës miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit “e) ligji për statusin e funksionarëve publikë”. Për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me shumicë të cilësuar prej 3/5 (tre të pestat) e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

III. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Kuvendi i Shqipërisë, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ka miratuar ligjin me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë të paketës së ligjeve prioritare të reformës në sistemin e drejtësisë.

Ky ligj ka vendosur një sërë garancish ligjore në drejtim të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet ligjit nr. 48/2019, miratoi në datën 18.07.2019 disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këto shtesa dhe ndryshime kishin si qëllim rregullimin dhe plotësimin e vakumit ligjor të krijuar në përmbajtjen e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të disa neneve të këtij ligji, me vendimin nr.34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

Nëpërmjet nismës së depozituar, si propozim i një grupi deputetësh synohet:

- përmirësimi i rregullimeve ligjore lidhur me kryerjen e ceremonisë publike të betimit si dhe plotësimin e vakumit ligjor të procedurës së betimit, në rast të përfundimit të afatit ligjor për kryerjen e ceremonisë së betimit për magjistratët para fillimit të ushtrimit të funksionit, Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për anëtarin e Gjykatës së Lartë. Plotësimi i këtij vakumi ligjor është i nevojshëm për të garantuar mirëfunksionimin e organeve gjyqësore dhe të prokurorisë, duke marrë në konsideratë që betimi është një moment i rëndësishëm, më të cilin lidhet fillimi i ushtrimit të mandatit të subjekteve të sipercituara;
- përmirësimi i parashikimit ligjor, sa i takon organeve kompetente në periudhën kalimtare, duke marrë në konsideratë konstituimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë të cilat ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore.

III.1 Përmbajtja e dispozitave të propozuara si nismë e një grupi deputetësh

1. Projektligji parashikon ndryshime në përmbajtjen e nenit 37 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëpërmjet kësaj dispozite, parashikohet që ceremonia e betimit të magjistratit të bëhet para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këto organe duhet që jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit të organizojnë ceremoninë e betimit. Dispozita parashikon se pas përfundimit të këtij afati, magjistrati kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Data e organizimit të ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të tij me shkrim pranë organit të emërtesës konsiderohet si dita e fillimit të detyres së magjistratit.

Propozimi i kësaj dispozite, vjen në përputhje me vlerësimin e Komisionit të Venecias, i cili në opinionin e tij të datës 22 Qershor 2006, CDL-AD (2006)016-e, ka trajtuar një rast të ngjashëm me Gjykatën Kushtetuese së Ukrainës. Në Opinionin e tij Komisioni i Venecias shprehet se: “Një procedurë efektive e emërimit nuk përbën garancinë e vetme për të shmangur bllokimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, Të metat në lidhje me mekanizmin e fillimit të detyrës mund të pengojnë punën e Gjykatës. Prandaj, çështja e administrimit të betimit duhet të trajtohet. Objektivi kryesor duhet të jetë sigurimi që betimi të bëhet në kohën e duhur dhe procedura e betimit të mos rezultojë në formalitete që mund të rrezikojnë fillimin e detyrës

së gjyqtarit.....Një nga zgjidhjet në këtë drejtim mund të jetë betimi në formë të shkruar dhe dorëzimi i tij Presidentit, ose Kryetarit të Parlamentit.”

Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur lidhur me rëndësinë e betimit të anëtarëve të organeve kushtetuese, si një shprehje e vullnetit për të marrë përsipër detyrat dhe përgjegjësit kushtetuese të funksionit. Në Vendimin e saj nr.44/2011 ajo ka mbajtur qëndrimin se: “*. Betimi është një akt që shërben për të deklaruar vullnetin, gatishmërinë, bindjen dhe vendosmërinë e mëtejshme të deputetit të mandatuar për të ushtruar funksionin e përfaqësuesit në Kuvendin e ri, në përputhje me rregullat e parashikuara për këtë qëllim. Betimi nuk është kusht për të bërë të vlefshëm mandatin e deputetit, pasi këtë e ka bërë komisioni zgjedhor, i cili e ka shpallur atë fitues nga votat e marra prej zgjedhësve. Mosbërja e betimit përbën një nga shkaqet e humbjes së mandatit parlamentar . Ky parashikim është bërë edhe për raste të tjera të fillimit të detyrës si p.sh nga Presidenti i Republikës , gjyqtarët, etj.”*

2. Ndryshimi tjetër i propozuar në nenin 61 të ligjit aktual propozohet në të njëjtën frymë me ndryshimet e propozuar në nenin 37 të ligjit, duke rregulluar betimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë që përzgjidhen mes juristëve të spikatur, dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Edhe në këtë aspekt, përcaktimi i një afati për realizimin e ceremonisë së betimit, si edhe parashikimi i mekanizmit zhbllokues, pra realizimi me shkrim i betimit dhe dërgimi i tij disa organeve të parashikuara nga ligji, siguron funksionimin normal të këtyre organeve kushtetuese.

Duke marrë në konsideratë që për një kategori magjistratësh siç janë anëtarët e Gjykatës së Lartë që vijnë nga rradhët e gjyqtarëve apo prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme, betimi tyre është bërë një herë, në momentin e emërimit dhe caktimit të tij në pozicionin e magjistratit, për këtë arsye ngritja në detyrë si anëtar të Gjykatës së Lartë apo Prokuror të Prokurorisë së Posaçme, vlerësohet se nuk kërkon një ceremoni të veçantë të kryerjes së aktit të betimit, për sa kohë që ligji nr. 96/2016 ka parashikuar që kalimi në këto detyra do të behet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

3. Projektligji propozon një saktësim në nenin 130, pika 2, sipas të cilës fjalët "institucione të tjera shtetërore, organizata" propozohet të zëvendësohen me fjalët "institucion publik apo subjekt privat".

4. Një ndryshim i rëndësishëm i propozuar nëpërmjet kësaj nisme lidhet me nenin 152 të ligjit aktual. Pavarësisht se kjo dispozitë është rishikuar me ndryshimet e miratuara në Korrik të vitit 2019, për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, propozimi nëpërmjet reformulimit të këtij neni ka si qëllim themelor rivendosjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe organin e prokurorisë, i cili ka përbërë edhe një nga prioritet kryesorë të reformës në drejtesi. Mundësia për të pezulluar nga detyra gjyqtarët dhe prokurorët të cilët, bazuar në të dhëna thelbësore faktike, që rrjedhin nga burime të besueshme, dyshohet se kanë kryer një shkelje të rënde, që mund të justifikojë shkarkimin e magjistratit, përbën një element thelbësor për të arritur këtë besim. Sanksionimi i masës së pezullimit nga detyra të magjistratit në rastet kur sjellja e tij, rrezikon të diskreditojë figurën e një magjistrati në publik, është një praktikë e ndjekur nga shumë vende anëtare të Bashkimit Evropian. Hetimet disiplinore mund të zgjasin deri në një vit. Këshilli përkatës në kushtet aktuale, nuk ka asnjë instrument ligjor në dispozicion për të vendosur pezullimin nga detyra të magjistratit, në rastin kur, për shembull, magjistratët dyshohet të jenë të përfshirë në një krim, por që nuk janë në kushtet e një mase sigurimi "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi" dhe përpara marrjes së cilësisë së të pandehurit. Kësisoj, magjistrati do të vazhdonte të gjykonte

ose të ushtronte ndjekje penale, çka do të rrezikonte të dëmtonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Ndryshimi i nenit 152 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vjen si nevojë e përcaktimit të hetimit paraprak që kryen Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbi verifikimin e besueshmerisë së burimit të informacionit apo ankesës së paraqitur dhe pas rezultatit pozitiv të këtij procesi, i paraqet Këshillit përkatës kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor dhe pezullimin e magjistratit.

Formulimi i këtij neni vjen në harmoni me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni i Venecias, i cili në opinionin e tij CDL-AD(2017)018, (Opinion mbi ligjin e sistemit gjyqësor në Bullgari) shprehet se:

"...Komisioni i Venecias pranon që një gjyqtar, kundër të cilit janë dërguar akuza serioze, mund të pezullohet nga detyrat. Sidoqoftë, duhet t'i përkasë Dhomës Gjyqësore të verifikojë se sa serioze dhe të bazuara janë këto akuza. Në versionin aktual të nenit 230, Dhoma Gjyqësore e SJC duket se kryen vetëm një rol zyrtar të aprovimit të pezullimit sa herë që prokuroria ka filluar mekanizmin sipas nenit 230. Në vend të kësaj, ligji për sistemin gjyqësor duhet të përcaktojë qartë se Dhoma Gjyqësore duhet të rishikojë përmbajtjen e akuzave dhe të vendosë nëse provat kundër gjykatësit janë mjaft bindëse (pa qenë domosdoshmërisht "përtej dyshimit të arsyeshëm") dhe nëse ka vend për pezullim. Kur e bën këtë, Dhoma Gjyqësore e SJC duhet të jetë në gjendje të përcaktojë afate të shkurtra kohore për hetime kundër gjyqtarëve të pezulluar."

Kjo dispozitë është në harmoni edhe me Notën shpjeguese të publikuar nga OSBE "Mbi standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve" e cila argumenton se:

"...Në rrethana të jashtëzakonshme dhe serioze, një gjyqtar i paditur mund të pezullohet nga puna gjatë fazës së hetimit - kjo është më pak disiplinore, dhe më shumë një masë e përkohshme, paraprake. Masat e tilla do të justifikohen vetëm nga natyra dhe rëndësia e veprës së pretenduar dhe / ose nëse pezullimi i gjykatësit mund të rrezikojë integritetin ose pavarësinë e tij / saj. Pezullimet e tilla në asnjë mënyrë nuk duhet të paragjykojnë rezultatit e procedurave. Kështu, ndërsa pezullohen, gjyqtarët duhet të marrin pagë të plotë, përveç nëse ato vonojnë paarsyeshëm procedurat ose nuk bashkëpunojnë me hetimin. Një numër vendesh evropiane parashikojnë këtë lloj pezullimi por e lejojnë atë vetëm në raste të rralla dhe të jashtëzakonshme në lidhje me vepra të rënda disiplinore, ose kur vlerësohet e domosdoshme për të ruajtur besimin e publikut në gjyqësor ose sistemin gjyqësor, ose kur një çështje penale është duke pritur kundër gjyqtar...."

Në përfundim projektligji propozon ndryshime edhe në nenin 160 të ligjit aktual duke marrë në konsideratë faktin që në kohën e propozimit të tyre Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ishte zgjedhur ende nga Kuvendi i Shqipërisë.

IV. PROÇESI I KONSULTIMIT TË PROJEKTLIGJIT

Në funksion të transparencës dhe konsultimit publik, pas përfshirjes së tij në Programin e Punës dhe Kalendarin e Punimeve të Kuvendit, projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar u është dërguar paraprakisht për opinion: Këshillit të Emërimeve në Drejtësi; Prokurorisë së Posaçme për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Shoqatës së

Gjyqtarëve; Shkollës së Magjistraturës; Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës; Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Fondacionit SOROS, Qendres “Res Publica”, Institutit të Studimeve Politike dhe USAID, duke u lënë në dispozicion një afat 10 ditor për paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve.

Bazuar në nenin 93 dhe 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë japin mendim për projektligjet ose për çështje të tjera që mund të ndikojnë mbi sistemin gjyqësor/prokurorisë dhe të drejtësisë në përgjithësi.

Paralelisht me kërkesën për dhënien e mendimeve është ngritur edhe një grup pune me përfaqësues të organeve të reja të sistemit të drejtësisë (Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë), Ministrisë së Drejtësisë, nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS. Në këto mbledhje ka marrë pjesë edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për problematika të lidhura funksionimin e këtij institucioni.

Paralelisht projektligji në mbështetje të nenit 82 pika 2 të Kushtetutës i është përcjellë për mendim edhe Këshillit të Ministrave.

V. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në parim, nismëtarët prezantuan përpara anëtarëve të Komisionit arsyet e ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore. Në vlerësimin e tyre, ky projektligj vjen në frymën e reformës në drejtësi dhe ka si qëllim përfshirjen e mekanizmit zhblllokues për institutin e betimit të magjistratëve duke u mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, por edhe në opinionin e Komisionit të Venecias. Njëkohësisht në fjalën e tyre nismëtarët theksuan se ky projektligj synon gjithashtu parashikimin e mekanizmave të pezullimit nga detyra të magjistratit në rastet kur sjellja e tij rrezikon të diskreditojë figurën e një magjistrati në publik, pas një hetimi paraprak që kryhet brenda afateve të shpejta nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Nga relatorja u theksua rëndësia e miratimit të kësaj nisme ligjore, si domosdoshmëri për rritjen e besimit të publikut në sistemin e ri të drejtësisë, për adresimin e problematikave të lindura në lidhje me institutin e betimit dhe për parashikimin e mekanizmave të nevojshëm he efektiv për t’iu përgjigjur rasteve kur magjistratët kryejnë veprime që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, veprime këto që sjellin edhe cënim të besimit të publikut në institucionet e drejtësisë dhe mosfunksionimin e shtetit të së drejtës.

Relatorja theksoi dhe nga institucionet e reja të drejtësisë, janë ngritur disa problematika të lidhura zbatimin në praktikë të paketës së ligjeve prioritare të reformës në drejtësi. Duke shprehur mbështetjen maksimale për adresimin e këtyre problematikave relatorja shprehu gadishmërinë për të mbështetur ndërhyrjet e mëtejshme në këto ligje, të cilat duke qënë se kërkojnë një analizë të plotë mbi problematikat, efektet dhe nevojën për adresimin e tyre do të vlerësohen në një moment të dytë.

Kryetari i Komisionit, vlerësoi qëllimin e kësaj nisme, e cila synon përcaktimin në projektligj të mekanizmave zhblllokues për formulën e betimit të magjistratëve dhe parashikimin e mjeteve në dispozicion në Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për adresuar situatat, që kërkojnë një reagim të shpejtë për të garantuar interesin publik nga njëra anë por edhe të drejtën për të proces të rregullt ligjor për magjistratin nga ana tjetër.

Ministrja e Drejtësisë, duke shprehur mbështetjen e institucionit që drejton për këtë nismë ligjore, u shpreh se qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve lidhet jo vetëm me nevojën për kthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, por edhe në garantimin e pavarësisë së

sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë dhe është në harmoni me një nga parimet thelbësore të reformës në drejtësi, atë të ndarjes së hetimit disiplinor nga gjykimi. Ministria e Drejtësisë u shpreh se aktualisht ky institucion ndodhet në fazën e kryerjes së një analize mbi problematikat e evidentuara nga organet e reja të sistemit të drejtësisë dhe shumë shpejt do të ngrihet një grup pune për të shqyrtuar dhe draftuar ndryshimet ligjore në paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, nën asistencën e partnerëve ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e Këshillit të Lartë Gjyqësor u shprehën në mbështetje të kësaj nisme ligjore, e cila rrit bashkëveprimin ndërmjet këtij organi dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe do të mundësojë ushtrimin efektiv të kompetencave të këtij organi, për sa i takon procedimit disiplinor nga magjistratëve.

VI. PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE TË MIRATUARA NË KOMISION

Shtesa dhe ndryshimet e miratuara në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në krahasim me variantin e depozituar si nismë deputetësh pas rakordimit të tyre në grupin e punës të ngritur me përfaqësuesit e organeve të drejtësisë nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS, janë si më poshtë:

- Plotësimi i dispozitës përkatëse që rregullon pagat e magjistratëve, duke përcaktuar në mënyrë specifike nivelin e shtesës për vështirësi për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky plotësim është i nevojshëm për të garantuar ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të tyre në proporcion me kufizimet e parashikuara për këtë kategori bazuar në parashikimet e ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin”.
- Duke marrë parasysh propozimet e bëra nga relatorja dhe grupi i punës në përmbajtjen e dispozitave përkatëse që parashikojnë betimin e magjistratëve, betimin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të Prokurorit të Përgjithshëm u miratuan disa ndryshime, me qëllim harmonizimin me parashikimet e Kushtetutës dhe qartësimin e këtyre dispozitave në përputhje me rregullat e teknikës legjislative.
Një çështje që mori vëmendje, gjatë shqyrtimit në Komision lidhej me shmangien e çdo paqartësie për sa i takon faktit që ndryshimet e propozuara në nenin 61 lidhur me betimin e gjyqtarëve, që vijnë nga rradhët e juristëve të spikatur janë në harmoni me parashikimin e nenit 136 pika 2 të Kushtetutës.
Lidhur me sa më sipër, vlerësohet se në çdo rast fillimi i detyrës është i lidhur me bërjen e betimit. Prandaj, në çdo rast, ceremonia e betimit edhe në rastin e shpalljes si i emëruar do të bëhet brenda 10 ditëve nga dita që gjyqtari shpallet i emëruar. Në këtë mënyrë respektohet edhe parashikimi kushtetues që gjyqtari e fillon detyrën brenda 15 ditëve, nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi afati 10 ditor i ceremonisë së betimit përfshihet brenda afatit kushtetues 15 ditor.
- Parashikimi i një dispozite shtesë, e cila i jep të drejtën Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve, të kërkojë informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, Policia e Shtetit, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të magjistratit si dhe çdo institucion tjetër kompetent për

verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkelje tjetër disiplinore. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në rast se nga verifikimi i pasurisë dhe figurës rezulton se ka dyshime të arsyeshme për kryrjen e ndonjë shkelje tjetër disiplinore, përveç rastit kur shkelja përbën vepër penale, merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit.

- Reformulimi i dispozitës përkatëse që parashikon pezullimin në rast procedimi disiplinor duke marrë në konsideratë:
 - a. Përcaktimin në mënyrë të specifikuar të rasteve që do të justifikojnë fillimin e procedurës së përsheptuar të hetimit paraprak nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
 - b. Në funksion të garantimit të parimit të procesit të rregullt ligjor është parashikuar e drejta e magjistratit për të shprehur shpjegimet e tij përpara Këshillit, përpara se ky i fundit të vendosë për pezullimin e magjistratit nga detyra.
 - c. Parashikimin e të drejtës së Këshillit për të vendosur masën e pezullimit nga detyra të magjistratit, jo vetëm në rastin procedurës së përsheptuar por edhe në rastin e procedurës normale, referuar parashikimeve të nenit 138 të ligjit. Në këtë frymë nga relatori dhe grupi i punës u propozuan edhe ndryshime në pikën 1 të nenit 138 të ligjit aktual.
- Deputët nismëtarë gjatë shqyrtimit në komision u tërhoqën nga propozimi i bërë për nenin 5 të projektligjit, i cili propozon ndryshimin e nenit 160 të ligjit aktual, pasi tashmë Kuvendi në seancën plenare të datës 20.01.2020 ka zgjedhur Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, i cili ka filluar ushtrimin e detyrës dhe në këto kushte nuk ndodhemi më para ndonjë periudhe kalimtare, e cila të justifikojë këtë propozim.

VII. PËRFUNDIME

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin, sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

RELATORE

KRYETAR

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. _____ / 2020

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, DATË 06.10.2016, “PËR
STATUSIN E GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 96/2016, datë 06.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12, pika 5, shkronja “d”, ndryshohet si më poshtë:

“d. Shtesë për vështirësi pune, në masën 60 përqind të pagës bruto fillestare, për magjistratët që ushtrojnë ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Neni 2

Në nenin 37 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “ceremoni publike” shtohet togfjalëshi “përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këshilli organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit të magjistratëve.”.

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3, si më poshtë:

“3. Nëse magjistrati nuk është thirrur për të bërë betimin, pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, ai betohet me shkrim sipas formulës të parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe ia dërgon atë të nënshkruar personalisht Këshillit. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim, pranë Këshillit konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të ushtrimit të funksionit të magjistratit.

Neni 3

Në nenin 38, pika 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” si më poshtë:
“ç/1) aktin e betimit sipas pikës 3 të nenit 37 të këtij ligji”.

Neni 4

Në nenin 61 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Mandati i anëtarit të Gjykatës së Lartë që përzgjidhet mes juristëve të spikatur fillon në ditën e betimit. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit ose e shpalljes i emëruar. Nëse anëtari i Gjykatës së Lartë nuk thirret për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë të nënshkruar personalisht Këshillit të Lartë Gjyqësor. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Akti i betimit përfshihet në dosjen personale të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 si më poshtë:

“2/1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm fillon në ditën e betimit. Ceremonia e betimit organizohet nga Kuvendi jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjes ose shpalljes i emëruar. Nëse Prokurori i Përgjithshëm nuk është thirrur për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Kuvendit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Kuvendit konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Akti i betimit përfshihet në dosjen personale të Prokurorit të Përgjithshëm.

2/2. Mandati i anëtarëve të Gjykatës së Lartë që ngrihen në detyrë nga radhët e gjyqtarëve fillon në datën e emërimit ose shpalljes i emëruar.

2/3. Mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme fillon në datën e ngritjes së tyre në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.”

Neni 5

Pas nenit 124 shtohet neni 124/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 124/1

Verifikimi i pasurisë dhe figurës

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve, sipas nenit 123 dhe 124, të këtij ligji, kërkon informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, Policia e Shtetit, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të magjistratit si dhe çdo institucion tjetër kompetent për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkelje tjetër disiplinore.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë informacion shtesë nga institucionet e përmendura pikën 1 të këtij neni, si dhe nga çdo institucion tjetër publik apo subjekt privat.

3. Çdo institucion publik apo subjekt privat duhet të përmbushë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në rast se nga verifikimi i pasurisë dhe figurës rezulton se ka dyshime të arsyeshme për kryerjen e ndonjë shkelje tjetër disiplinore, përveç rastit kur shkelja përbën vepër penale, merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit sipas përcaktimeve të nenit 125 të këtij ligji.”

Neni 6

Në nenin 130, pika 2, togfjalëshi “institucione të tjera shtetërore, organizata” zëvendësohet me togfjalëshin “institucione publike apo subjekte private”.

Neni 7

Në nenin 138, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përveç parashikimeve të nenit 152 të këtij ligji, nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.”

Neni 8

Neni 152 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 152

Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor

1. Kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen menjëherë një hetim paraprak për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit sipas nenit 124 të këtij ligji ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji. Kur Inspektori

i Lartë i Drejtësisë krijon bindjen, se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar i paraqet Këshillit përkatës, raport të arsyetuar për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ose në nenin 138 të këtij ligji, pezullon magjistratin nga detyra, kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Këshilli mund të kërkojë, informacion mbi shkeljen e pretenduar pranë çdo institucioni publik ose subjekti privat. Në rastin e procedimit disiplinor sipas pikës 1 të këtij neni, Këshilli vendos menjëherë por jo më vonë se tre ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, duke i dhënë mundësinë magjistratit për të parashtruar argumentet e tij në mbledhjen e Këshillit.

3. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156 të këtij ligji.

4. Pavarësisht parashikimeve të nenit 138 pika 5, të këtij ligji, Këshilli kur çmon se ka nevojë për hetime të mëtejshme për shkeljen disiplinore i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë këto hetime, pa qënë nevoja për të specifikuar elementët që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen me përparësi hetime të mëtejshme për këto shkelje dhe i paraqet Këshillit raportin dhe dosjen e hetimit.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI